

KONCEPTI:

Qysh se shkenca nuk u zë besë shpjegimeve të përgjithshme dhe zgjidhjeve që nuk janë sektoriale dhe te veçanta, sfida e madhe për artin në përgjithësi është të dije të ndërthurë dijet e ndryshme dhe kodet e ndryshme në një vizion të shumëfishite e të shumanshëm të botës -Italo Calvino-

Në duar keni disa prej pikturave digjitale (grafik dizajn), ku tek secila me vete (jo si tërësi kompozicionale ekspozuese – larg ekspozitës tematike), tregojnë dhe shprehin copëza të shpirtit rebel të artistit të rafinuar. Jam munduar që kualiteti i tyre formal dhe përmbajtjesor, ti respekton standardet krijuese evropiane e botërore. *Duke u nisur nga mënyra e realizimi, pa hezitim mund të them që paraqesin risi për ambientin tonë krijues, ngaqë që të gjitha pa përjashtim janë punuar vetëm duke përdorur një numër të caktuar aplikacionesh për telefonat inteligjent (Smartphone samssung galaxy S2 dhe S4.)*

Erdhi koha të vëmë pak rregull tek idetë që kam sjelle dhe grumbulluar si shembuj të larmisë. Më poshtë, duke përdorur një ekonomi të shprehjeve verbale, po mundohem të shpjegoj në mënyrë konceptuale se çka përmban secila prej tablove:

1. "Arkitripi". Dizajn Grafik (Grafike digjitale) Dim: 35cmx40cm.

Ne prapavinë qendrore, shfaqen elementet e thjeshtëzuara dhe të apstraguara të një fasade. Ngjyrat dhe dritëhijet, që të gjitha vijnë si refleksione të ndjesive të mija gjatë udhëtimeve të fundit, udhëtime të cilat kishin synimin kryesor *Studimin vizuar të Arkitekturës në qendrat Evropiane.*

2. "Identiteti". Dizajn Grafik (Grafike digjitale). Dim: 56cmx74cm.

Pozitë qendrore në kuadër të tablosë zënë vend simboli ynë - shqiponja dykrerëshe. Simbol i cili përforcon identitetin tone kombëtar shqiptar. Shqiponja është realizuar me një vijëzim ngjyre të erret dhe hijezim të lehte që të jep përshtypjen e një vule – vule me të cilën është vulosur dhe shpirti im. Shqiponja tashme e vulosur, qëndron e gdhendur në dejet e prerjes tërthore të lisit – lisit shumëvjeçar shqiptarë. Dy ngjyrshmëria e së kuqes dhe së hirtës, që ndërton pjesën më të madhe të dit-hijes së tablosë, i shkon përshtati të gjith historise sonë të lavdishme.

3. "Relike e kohes". Dizajn Grafik (Grafike digjitale).Dim: 35cmx40cm.

Prap simboli ynë kombëtarë, i nxjerrë nga zbukurimet e brezit të xhubletës shqiptarë është kornizuar në këndin e majte në pjesën e sipërme të tablosë, duke theksuar përjetësi në udhëtimin e përjetshëm të rrjedhës së pandalshme të kohëve.

4. "Mbretëresha në fron". Dizajn Grafik (Grafike digjitale). Dim: 85cmx113cm.

Historia e Mbretëreshës në fron, e abstraguar dhe e ardhur këtu në fronin e Kosovës. Portreti i abstraguar i një vashe qëndron në mesin e poshtëm të tablosë dhe prapa saj shtrihet harta e Kosovës e cila njëherit është edhe burimi i ndriçimit të përgjithshëm të tablosë. Paleta e ngjyrave gjate gjithë kohës të mban dhe të shtynë drejt legjendave të panumërta që linden si ndërthurje e mitologjisë dhe historisë sonë.

5. "Udhëtimi Epik ". Dizajn Grafik (Grafike digjitale). Dim: 65cmx115cm

Hijet – janë forma të provuara nga një përdorim i gjate, ku atyre, në këtë tablo iu japa strukturën e një miti.

6. "Moshë". Dizajn Grafik (Grafike digjitale).Dim: 85cmx107cm

Asgjë më shumë se sa shpjegimi figurativ i numërimit të rrethëve koncentrik tek prerja tërthore e një tringju nuk e shpjegon moshën. Moshë është edhe një barometër shpjegues i harxhimit të së shkuarës, së tashmes dhe së ardhmes në supet e njëra tjetrës. E sotmja, është fakt akumulimi i se kaluarës. Në këtë përsiatje filozofike, pjesën qendrore të tablosë e zënë tringju me *vitet* e tij koncentrik,.....

7. "Artistja" - © V. Haxhibeqiri. Dizajn Grafik (Grafike digjitale). Dim: 50cmx58cm

Ne një galeri pikturash, një njeri shikon pejsazhin e një qyteti të padukshëm, dhe ky pejsazh hapet për të përfshirë edhe galerinë që e përmban edhe njeriun që po e sodit.

8. "Zonja ZA" - © V. Haxhibeqiri. Dizajn Grafik (Grafike digjitale).Dim: 41cmx74cm

Ne këtë tablo, jam përpjekur të kap shpirtin e botes në një figure të vetme midis pafundësisë së atyre që mund të imagjinohen; por për të bërë këtë mu deshtë t'i jap tablosë një intensitet të tillë sa që në fund të fundit ajo nuk do mund të çonte më në një botë jashtë saj. Mos u çuditni, normalisht që dështova ta arrijë këtë, por u vet-mjaftova me rezultatin që po e shihni edhe ju. U vet-mjaftova me frymën e cila bën që fantastikja të lind nga e përditshmja, një fantastike e shpirtëzuar, mendore, e padukshme, e cila do të arrijë majat e saj tek "Zonja ZANA", gruaja ime!

9. "BPortret" - © V. Haxhibeqiri. Dizajn Grafik (Grafike digjitale).Dim: 50cmx50cm.

10. "Pritja" - © V. Haxhibeqiri. Dizajn Grafik (Grafike digjitale).Dim: 115cmx65cm

Si arkitekt, në përditshmërinë time profesionale por edhe atë personale jam i rrethuar me element të ndryshëm që bashkëveprojnë për të formuar pjesën e dukshme të imagjinatës artistike: vëzhgimi i drejtpërdrejtë i botes reale, shpërfytyrimi mes ëndrrash, bota e figurshme e përçarë në nivelet e saj të ndryshme, dhe një proces abstraksionizmi, kondensimi dhe shpirtëzimi i përvojës njësoje, me rendësi të madhe si në vizualizimin ashtu edhe në verbalizimin e mendimit.

Visar Q. Haxhibeqiri